



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:287088

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05637074

KPPP.nr.2209/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit INTERPLAST GROUP, me seli në fshatin Shupkoc në Mitrovicë, kundër debitorit “Pajtimi Mall” Sh.P.K., me seli në Malishevë, GJ.K-Skënderbeu p.n, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.308/23 të datës 21.11.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Eset Murati me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Pajtimi Mall” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.308/23 të datës 21.11.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Eset Murati, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.308/23 të datës 21.11.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.5527/20 të datës 27.11.2020, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 2,891.00 Euro, me kamatë ligjore vjetore prej 8 % nga dita e rënies në vonesë 28.11.2020 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbauesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me arsyetimin se urdhri përmbauesit është i panevojshëm, i ngutshëm dhe aspak ekonomik, duke shtuar se debitori në cilësinë e bashkëpunëtorit me kreditorin kanë pasur raporte të mira për shumë vite, dhe njëherit kanë shprehur vullnetin e lirë që për çështjen e borxhit në fjalë t'ia jap një afat shumë të shkurtër, mirëpo kreditori ka mashtruar dhe lëndën e ka dërguar tek Përmbauesi Privat pa asnjë njoftim. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri përmbauesit të anulohet në tërësi apo të ndryshohet sa i përket shpenzimeve rritëse të faturës përmbauese.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se përmbauesi është caktuar në bazë të propozimit të kreditorit dhe dokumentit përmbauesit-faturës e në përputhje me nenin 29 të LPP-së. Më tej ka shtuar se shkaqet e prapësimit janë të parapara në mënyrë decidive në nenin 71 të LPP-së, dhe pasi që debitori në prapësimin e ushtruar nuk ka ofruar kurrfarë provash me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij dhe qëllimi i tij është zvarritja e pagesës së borxhit, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri P.nr.186/22 i datës 12.07.2022 të mbetet në fuqi, si dhe në rast të ushtrimit të ankesës të obligohet ta paguaj garancionin në shumën e plotë të kredisë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbauesi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbauesit po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbauesit paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbauesi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.5527/20 të datës 27.11.2020 në shumën prej 10,391.00 Euro, dhe nga kjo faturë debitori ka arritur që ta paguajë një pjesë të borxhit në shumën prej 7,500.00 Euro, ndërsa borxhi i mbetur është në shumën prej 2,891.00 Euro, fakt ky i cili vërtetohet në propozimin për përmbarim nga vet kreditori.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur përmban të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me vulën dhe nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2209/23, me datë 24.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2023:287088
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637074